

# **KODI I ETIKËS GJYQËSORE**

Një pushtet gjyqësor efektiv dhe i pavarur është i domosdoshëm për drejtësinë dhe shtetin e së drejtës. Gjyqtarët duhet të marrin pjesë në procesin e përcaktimit, respektimit dhe zbatimit të standardeve të larta të sjelljes dhe duhet të ruajnë një pozicion që e bën të mundur pavarësinë, paanësinë dhe drejtësinë e tyre si gjyqtare. Rregullat që burojnë nga Kodi i Etikës Gjyqësore hartohen për të ndihmuar në arritjen e këtyre qëllimeve dhe për të përmbushur standarde të tilla të sjelljes së gjyqtarëve në realizimin e funksioneve të shtetit të së drejtës.

Për të siguruar që drejtësia dhe funksioni i pushtetit gjyqësor të realizohen në përputhje me Kushtetutën, në gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë do t'u përmbahemi rregullave të mëposhtme:

## **KREU I**

### **RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR PAVARËSINË DHE PAANËSINË E GJYQTARIT**

#### **Rregulli 1**

Gjyqtari duhet të mbrojë dhe të mbështesë pavarësinë dhe paanësinë e pushtetit gjyqësor. Gjyqtari duhet të respektojë dhe zbatojë Kushtetutën e ligjet dhe duhet të veprojë gjithmonë në mënyrë që të rrisë besueshmërinë e publikut në pavaresinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

#### **Rregulli 2**

Gjyqtari duhet të përmbushë detyrat e tij duke treguar kujdesin maksimal në respektimin e ligjeve dhe në rritjen e nivelit të eksperiencës profesionale. Gjyqtari duhet të tregojë kurajo civile dhe nuk duhet të ndikohet nga interesa të njëanshme, presioni publik e shtetëror, apo frikës për shkak të kritikave.

#### **Rregulli 3**

Gjyqtari nuk duhet të lejojë që familja, të afërmit e tij apo persona të tjerë të influencojnë në punën dhe vendimet e tij. Ai nuk duhet të çenojë prestigjin e detyrës gjyqësore për hir të interesave private dhe në të njëjtën kohë nuk duhet t'u krijojë të tjerëve përshtypjen se vepron në mënyrë të tillë.

## **KREU II**

### **RREGULLA QË LIDHEN ME USHTRIMIN E FUNKSIONEVE GJYQËSORE**

#### **Rregulli 4**

Gjatë punës së tij gjyqtari duhet të shmangë çdo sjellje të papërshtatshme dhe që bie në kundërshtim me ligjin, kodin e etikës, si edhe veprime që mund të dëmtojnë ose të hedhin dyshime mbi figurën e tij morale.

### **Rregulli 5**

Gjyqtari gjatë ushtrimit të funksioneve të tij gjyqësore duhet të shmangë njëanshmërinë dhe paragjykimet për shkaqe që lidhen me racën, seksin, besimin fetar, kombësinë, gjendjen social-ekonomike, moshën, paaftësinë mendore ose fizike, e shkaqe të tjera që lidhen me palët në proces.

Një gjë të tillë nuk duhet t'ia lejojë as palëve në proces, as nëpunësve gjyqësor dhe atyre që i nështrohen urdhërave dhe kontrollit të gjykatës.

### **Rregulli 6**

Gjyqtari duhet t'u japë zgjidhjen e duhur, me efikasitet dhe me drejtësi të gjitha çështjeve gjyqësore, duke respektuar me korrektesë Kushtetutën dhe ligjet. Vendimet duhet të përmbajnë shpjegim dhe arsyetim të plotë të shkaqeve që e kanë çuar gjykatën në vendimin e dhënë.

### **Rregulli 7**

Gjyqtari duhet t'u kushtojë kohën e nevojshme çështjeve gjyqësore në mënyrë që t'i studiojë dhe t'i zgjidhë ato, duhet të jetë i përpiktë në fillimin dhe drejtimin e seancës gjyqësore dhe nuk duhet të lejojë vonesa në punën e tij.

### **Rregulli 8**

Gjyqtari duhet të sigurojë rregull dhe respektim të solemnitetit gjatë seancave gjyqësore. Sjellja e tij ndaj pjesëmarrësve në seancat gjyqësore duhet të jetë e paanëshme dhe dinjitoze. Këtë sjellje ai duhet ta kërkojë edhe nga palët në proces, nëpunësit gjyqësor dhe personave të tjerë që i nështrohen urdhërave dhe kontrollit të gjykatës.

### **Rregulli 9**

Gjyqtari duhet të respektojë të drejtën e çdo personi që ka interes ligjor për çështjen në gjykim dhe të mbrojtësit të tij, për tu dëgjuar në përputhje me ligjin. Në shqyrtimin e një çështje gjyqësore, ai nuk duhet të marrë parasysh bisedime të njëanshme apo të bëra pa prezencën e palëve.

### **Rregulli 10**

Gjyqtari nuk duhet të bëjë komente publike që mund të ndikojnë në rezultatin e gjykimit të një çështje që ai ka ose do të ketë në shqyrtim, ose të cënojë drejtësinë, ose të bëjë ndonjë koment jopublik, i cili mund të cënojë në mënyrë thelbësore zhvillimin e një gjyqi të drejtë. Të njëjtin qëndrim gjyqtari duhet t'u kërkojë edhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues si dhe personelit gjyqësor që i nështrohet urdhërave dhe kontrollit të tij.

Përrjashtohet nga ky rregull rasti kur gjyqtari bën diskutim publik për shpjegimin e procedurave gjyqësore që do të ndiqen.

### **Rregulli 11**

Gjyqtarit i ndalohet të përhapë informacione, të bëjë deklarata, të bëjë të ditura mendimet që janë shfaqur gjatë seancave të gjykimit, dhe që akoma nuk kanë marrë formën e një vendimi, apo të deklarojë përmbajtjen e dokumenteve me karakter sekret ose vetjak.

### **Rregulli 12**

Gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i një çështje, ose me kërkesën e secilës nga palët mund të përjashtohet nga gjykimi, kur paanësia e tij mund të vihet në diskutim, për shkak të rasteve të mëposhtme, por duke mos u kufizuar në to:

- a. Kur influencon ose paragjykon njërën nga palët ose avokatin e saj.
- b. Kur ka qenë avokati mbrojtës i njëres nga palët në çështjen që aktualisht ka në shqyrtim.
- c. Kur është në dijeni se ai personalisht ose familja apo të afërmit e tij kanë një interes material në përfundimin e çështjes që gjyqtari do të shqyrtojë ose në qoftë se ekziston mundësia dëmtimit të shtetit ose cdo pale tjetër nga qëndrimi paragjykues i gjyqtarit.
- d. Kur anëtarët e familjes së tij janë dëshmitarë ose mund të luajnë rol të tillë në një çështje që gjyqtari do të marrë në shqyrtim.
- e. Kur bashkëshorti i gjyqtarit ose çdo i afërm në bazë lidhjesh gjaku deri në tre breza tregojnë interes në këtë çështje. Shkalla e lidhjeve të gjakut përcaktohet nga Kodi i Procedurës Civile.
- f. Në të gjitha rastet e tjera që parashikohen në Kodet e Procedurës Civile dhe Penale.

### **Rregulli 13**

Gjyqtari që merr dijeni se një gjyqtar tjetër ka mundësi të ketë shkelur rregullat e këtij Kodi duhet të veprojë në mënyrë të përshtatshme, dhe kur shkelja përbën një çështje thelbësore për mbarëvajtjen e punëve të gjyqtarëve të tjerë duhet të informojë autoritetin e duhur.

Gjyqtari që merr dijeni që një avokat ka mundësi të ketë shkelur Rregullat e Sjelljes Profesionale duhet të veprojë në mënyrë të përshtatshme, dhe kur shkelja përbën një çështje thelbësore për ndershmërinë, besnikërinë dhe mbarëvajtjen e punëve të avokatit lidhur me probleme të tjera, duhet të informojë autoritetin e duhur.

### **Regulli 14**

Gjyqtari duhet të përmbushë me përkushtim përgjegjësitë administrative në mënyrë të paanshme, pa paragjykime dhe duhet të ruajë pozitën profesionale gjatë administrimit gjyqësor, si dhe duhet të bashkëpunojë me gjyqtarë të tjerë dhe nëpunësit gjyqësor në administrimin e punëve të gjykatës.

Gjyqtari duhet t'i kërkojë stafit, nëpunësve dhe personave të tjerë që i nënshtrohen urdhërave dhe kontrollit të gjyqtarit të kujdesen për standardet e besueshmërisë dhe përkushtimit që i

përkasin gjyqtarit dhe që të mos manifestojë njëanshmëri dhe paragjykim gjatë realizimit të detyrave të tyre gjyqësore.

Gjyqtari me funksion drejtues duhet të marrë masa të nevojshme për të siguruar dërgimin e rregullt të çështjeve para tyre dhe realizimin e detyrave të tjera gjyqësore që u përkasin atyre.

Gjyqtari me funksion drejtues nuk duhet të bëjë propozime për emërimë të panevojshme. Ai duhet të ushtrojë pushtetin e tij për propozimin për emërimë në mënyrë të paanshme dhe duhet të bazohet në merita, duke mënjanuar nepotizmin dhe favorizimet.

### **KREU III**

## **RREGULLA PËR VEPRIMTARINË JASHTË GJYQËSORE**

### **Rregulli 15**

Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor, ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore.

### **Rregulli 16**

Gjyqtari nuk duhet të marrë përsipër detyra që bien në kundërshtim me funksionin e tij. Ai mund të marrë pjesë në aktivitete që kanë për qëllim përmirësimin e legjislacionit që lidhet me pushtetin gjyqësor dhe të administrimit të drejtësisë.

Gjyqtari nuk mund të kryejë këshillime për çështje konkrete gjyqësore dhe nuk mund të marrë pjesë në organizata apo komisione që merren me zgjidhjen e çështjeve konkrete. Ai mund të marrë pjesë në organizma që ekzistojnë ose krijohen për të promovuar probleme që kanë të bëjnë me sistemin ligjor.

### **Rregulli 17**

Gjyqtari nuk duhet të anëtarësohet në organizata të cilat mbajnë qëndrime ekstreme për probleme të caktuara, organizata që kanë qëndrim armiqësor ose poshtërues ndaj gjykatave, që kërkojnë angazhim kohe të gjyqtarit dhe që e pengojnë atë të kryejë normalisht detyrën e tij, apo organizata të cilat shfrytëzojnë anëtarësinë e gjyqtarit për të përfituar.

Gjyqtari nuk mund të jetë anëtar në një organizatë që ndjek praktika diskriminuese për arsye të racës, seksit, besimit fetar ose origjinës kombëtare apo çdo lloj diskriminimi tjetër.

### **Rregulli 18**

Gjyqtari nuk mund të anëtarësohet në parti politike ose të marrë pjesë në aktivitete politike. Ai nuk duhet të sigurojë materiale konkrete ose mbështetje financiare për organizatat politike duke përdorur pozicionin e tij zyrtar.

Gjyqtari gjatë zgjidhjes së çështjeve me karakter politik, nuk duhet të shfaqë mendime ose të adoptojë qëndrime të ndryshme nga ato që parashikon ligji.

## **Rregulli 19**

Gjyqtari nuk duhet të lejojë që marrëdhëniet familiare, sociale, politike apo marrëdhënie të tjera, të ndikojnë në sjelljen gjyqësore të gjyqtarit ose në gjykim. Gjyqtari nuk duhet as ta përdorë autoritetin e të qenit gjyqtar për të arritur, përmbushur interesat e tij ose të tjeve dhe as nuk duhet të krijojë ose të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se ata gjenden në një pozitë të veçantë për të ndikuar mbi gjyqtarin.

## **Rregulli 21**

Gjyqtari mund të flasë, të japë leksione, dhe të marrë pjesë në veprimtari të tjera jashtëgjyqësore që lidhen me legjislacionin, sistemin gjyqësor, administrimin e drejtësisë.

## **Rregulli 22**

Gjyqtari duhet të kryejë aktivitetet e tij jo-gjyqësore në mënyrë të tillë që të shmangë ose të minimizojë rrezikun e konfliktit me detyrat gjyqësore.

## **Rregulli 23**

Gjyqtari dhe anëtarët e familjes së tij nuk duhet të pranojnë dhurata, favore, privilegje ose premtime për ndihmë materiale nga një person që ka interes direkt ose indirekt në një çështje që gjyqtari do të shqyrtojë.

## **Rregulli 24**

Gjyqtari nuk duhet të përfshihet në marrëdhënie financiare ose pune që mund të kuptohen si shfrytëzim i funksionit gjyqësor të gjyqtarit, ose që e përfshijnë gjyqtarin në marrëdhënie të shpeshta ose krijojnë marrëdhënie biznesi mes gjyqtarit dhe avokatëve që mund të paraqiten në gjykatën ku gjyqtari ushtron aktivitetin.

## **Rregulli 25**

Gjyqtari nuk duhet të shërbejë si zbatues, administrator ose përfaqësues, kujdestar, mbikqyrës, përgjegjës, ose të kryejë aktivitete të tjera drejtuese.

Gjyqtari nuk duhet të shërbejë si administrator, nëse ka mundësi që ai si administrues të përfshihet në një proces që mund të paraqitet për gjykim gjyqtarit, ose kur pasuria, të ardhurat ose fëmija nën kujdestari mund të përfshihet në një konflikt gjyqësor në gjykatën në të cilën gjyqtari shërben ose gjykatën nën autoritetin apelues të gjykatës ku ai punon.

Të njëjtat kufizime mbi aktivitetet financiare që zbatohen ndaj një gjyqtari personalisht do të aplikohen edhe për një gjyqtar me cilësinë e administratorit.

## **KREU IV**

### **ZBATIMI I KODIT**

## **Rregulli 26**

Të gjithë gjyqtarët duhet të zbatojnë rregullat e këtij Kodi të Etikës Gjyqësore.

## **Rregulli 27**

Komisioni i Etikës Gjyqësore Kombëtare, nëpërmjet interpretimit të normave të Kodit të Etikës Gjyqësore dhe të normave ligjore që rregullojnë sjelljen e gjyqtarëve, i jep opinione këshillimore Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me kërkesën e këtij të fundit.

Çdo gjyqtar ka të drejtë të kërkojë nga Komisioni i Etikës një opinion këshillimor lidhur me sjellje apo veprime të caktuara gjatë kryerjes së detyrës apo jashtë saj, nëse ato konsiderohen ose jo në pajtim, me normat e Kodit të Etikës Gjyqësore. (ndryshuar më datë 08.12.2006 në Mbledhjen Vjetore të Konferencës Gjyqësore Kombëtare).

## **Rregulli 28**

Interpretimi i Kodit të Etikës Gjyqësore, i bërë nga Komisioni i Etikës i Konferencës Gjyqësore Kombëtare, me kërkesën e një gjyqtari, lidhur me faktin nëse norma përkatëse e lejon një sjellje të caktuar, mund të përdoret si mjet mbrojtjeje nga ana e tij në rast procedimi disiplinor, por ky interpretim nuk ka karakter detyrues për zgjidhjen e rasteve të tjera të ngjashme nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. (ndryshuar më datë 08.12.2006 në Mbledhjen Vjetore të Konferencës Gjyqësore Kombëtare).

## **Rregulli 29**

Rregullat e këtij Kodi zbatohen edhe për nëpunës që merren me veprimtari administrative në gjykatat e shkallës së parë, të apelit dhe në Gjykatën e Lartë.

Gjyqtarët dhe nëpunësit administrativë të pushtetit gjyqësor të marrin masa që t'i rregullojnë marrëdhëniet dhe veprimtarinë e tyre në pajtim me rregullat e këtij Kodi sa më shpejt që të jetë e mundur.

## **KONFERENCA GJYQËSORE KOMBËTARE**

**TIRANË, MË 08.12.2006**